



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
NJËSIA PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____, _____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sisteme Elektronike”

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**
- 35121700-5- Sisteme alarmi
- 31625200-5- Sistemi alarmi anti-zjarr
- 31625300-6- Sisteme alarmi anti-vjedhje
- 35125300-2- Kamera Sigurie

VLERA E FONDIT LIMIT: 63,031,119 (Gjashtëdhjetë e tre milion e tridhjetë e një mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) **LEK PA TVSH** dhe **662,996.94** (Gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nentëqind e nentëdhjetë e gjashtë presje nentëdhjetë e kater) **Euro pa TVSH**

***Shënim:** Vlerat në lekë janë konvertuar në monedhen euro me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë më datë 10.06.2026, me kurs kembimi **95.07** (Nentëdhjetë e pese presje zero shtate) Lek/Eur.

Sigurimi i ofertës 2%: **1,260,622,38** (Një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzetë e dy presje tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSH dhe **13,259.94** (Tremëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nente presje nentëdhjetë e kater) Euro pa TVSH e fondit limit, sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor Shoqëria “Illyrian Guard” Sh.a. ka

hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. ARGUMENTIMI KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të neneve 76 dhe 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenit 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM Nr 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), nga data e zhvillimit të tenderit të jetë sa vlera e përllogaritur e marrëveshjes kuadër. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare

konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë ne konsiderate specifiken e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare te jete jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit. sipas parashikimeve te pikes 2 b) te Nenit 43 te VKM-se.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në Nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku citohet: 1. “Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel, se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Per efekte fiskale, te dhenat e dokumenteve te mesiperme quhen te pranuar, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojne dy muaj pas dorezimit te tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk pergjigjet zyrtarisht“, eshte bazuar ne kërkesat e Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij. Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen

për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë shlyer detyrimet financiare të taksave vendore të parashikuara nga Njësia/të e Pushtetit Vendor për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026, referuar Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të cilën/at janë regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi. Dokumentet provuese, vërtetimet e kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ne ligjin Nr.9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme ISO ose ekuivalentet e tyre, të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara dhe të njohura nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) **ISO 9001** – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë;
- b) **ISO 20000-1** – Menaxhimi i Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit (ITSM);
- c) **ISO 27001** – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.

Argumentimi:

Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e Nenit 36 dhe Nenit 77, pikes 1 te nenit 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Si dhe Nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet: 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokures të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për te kryer shërbimin objekt kontrate. Këto certifikime kërkohen për të siguruar që*

operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetet organizative dhe standardet e nevojshme për realizimin me cilësi, siguri dhe efikasitet të objektit të kontratës.

- a) **ISO 9001** kërkohet për të garantuar menaxhimin e cilësisë, kontrollin e proceseve, identifikimin e rreziqeve dhe ofrimin e mallrave/shërbimeve sipas standardeve ndërkombëtare.
- b) **ISO 20000-1** siguron që operatori ekonomik disponon procese të strukturuar për menaxhimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, duke garantuar ofrim efikas dhe cilësor të shërbimeve të kontratës.
- c) **ISO 27001** garanton zbatimin e standardeve për sigurinë e informacionit, mbrojtjen nga sulmet kibernetike dhe rrjedhjet e të dhënave, menaxhimin e rreziqeve, përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për furnizimin dhe suportin e pajisjeve të kërkuara sipas Tabela nr.1: “*Lista e Pajisjeve Elektronike*”. Nëse autorizimi lëshohet nga distributori, duhet të provohet lidhja e tij me prodhuesin. Dokumenti duhet të përmbajë të dhënat e prodhuesit (telefon, e-mail dhe website) për qëllime verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa për autorizim garanton origjinën, cilësinë dhe mbështetjen zyrtare të pajisjeve, si dhe vërteton se operatori ekonomik është i autorizuar për furnizimin e tyre. Ky dokument i jep Autoritetit Kontraktor siguri për aftësinë e operatorit ekonomik në realizimin me sukses të kontratës. Kriteri është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

Tabela nr.1: “*Lista e Pajisjeve Elektronike*”:

Numrat sipas specifikimeve më poshtë	Emertimet
1.	NVR (Network Video Recorder) me 4 kanale
2.	NVR (Network Video Recorder) me 8 kanale
3.	NVR (Network Video Recorder) me 16 kanale
4.	HDD 4 TB
5.	HDD 6 TB
6.	Kamera e jashtme me Ngjyra 24/7
7.	Kamera e brendshme me Ngjyra 24/7
8.	Kamera e jashtme Inteligjente
9.	Kamera e brendshme Inteligjente
10.	Kamera me rrotullim 360 grade
11.	Kamera Termale
12.	Kamer Trupi “Body camer”
13.	PoE Switch 5 Porta
14.	PoE Switch 9 Porta
15.	Switch 5 porta i thjesht

16.	Paneli Alarmit
17.	Ekspander Wireless
18.	Tastier Komandimi Wireless
19.	Pult Komandimi për Panelin e Alarmit
20.	Sensorë Lëvizje (Volumetrik) me tela i brendshëm
21.	Sensorë Lëvizje (Volumetrik) Wireless brendshëm
22.	Sensore dedektimi Tymi me tela i brendshëm
23.	Sensore dedektimi Tymi Wireless i brendshëm
24.	Sirenë
25.	Akses kontroll
26.	Akses Kontroll me njohje Fytyre “Face Access Terminal”
27.	Monitor
28.	UPS 1000VA
29.	Tra Parkimi
30.	Kamera për njohje Targe
31.	Tripodë
32.	Dedektor metalik dore
33.	Metal Dedektor tipi “Ure”

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi sipas Tabeles nr.1: “*Lista e Pajisjeve Elektronike*”, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në website të tyre përkatës.

Argumentimi:

Kjo kërkesë bazohet në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285/2021. Ajo i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar kapacitetin e operatorit ekonomik dhe përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Katalogët zyrtarë sigurojnë informacion autentik dhe të krahasueshëm, ndërsa përkthimi dhe noterizimi garantojnë saktësi dhe kuptueshmëri në vlerësim. Verifikueshmëria në faqen e prodhuesit rrit transparencën, besueshmërinë dhe objektivitetin e procesit të vlerësimit.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 12 (dymbëdhjetë) punonjës të diplomuar në fushën e Telekomunikacionit, Elektronikë, Informatike, Teknologji Informacioni, Elektrike).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (fushën e programit të përfunduar) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit,

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

- Diplomat Universitare në programet e studimit në fushën e Telekomunikacionit, Elektronikë, Informatike, Teknologji Informacioni, Elektrike.
- Duhet të figurojnë në Listepagesat e kompanisë E-Sig për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi: Kërkesa për kualifikimin e nevojshëm profesional është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga çdo operator ekonomik që ka në objektin e veprimtarisë së tij furnizimin me mallra me qëllim përmbushjen e veprimtarisë së Shoqërisë.

Mallrat objekt prokurimi janë të një rëndësie të veçantë për shoqërinë “Illyrian Guard” sh.a., duke pasur parasysh kapacitetin teknik dhe profesional, si dhe në përpjesëtim me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, me qëllim garantimin e realizimit me sukses të saj

Ky kriter mbështetet në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë staf të kualifikuar si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar në menaxhim projektsh (PMP ose PRINCE2)**, (ose ekuivalent), për menaxhimin profesional të kontratave.
- Të paktën 4 (katër) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të kamerave** (ose ekuivalent), për instalim korrekt dhe pa problematika teknike.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të alarmeve** (ose ekuivalent), për instalimin e saktë të këtyre sistemeve.
- Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të aksesit kontrollit** (ose ekuivalent), për implementimin e tyre.
- Të paktën 2 (dy) punonjës me certifikatë për sigurinë teknike në punime elektrike** (ose ekuivalent), për garantimin e sigurisë gjatë instalimit dhe operimit të pajisjeve.

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikim.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje certifikimet e punonjesve dhe listepagesat perkatese E-Sig.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (tipin e certifikatave përkatëse) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

- Certifikatat përkatëse sipas kërkesës së Autoritetit.
- Duhet të figurojnë në Listepagesat e kompanisë E-Sig për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi:

a) të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar PMP ose PRINCE2 (ose ekuivalent):

Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik ka në staf një person të kualifikuar në menaxhimin profesional të projekteve, i cili do të jetë i angazhuar në menaxhimin e kontratave në kuadër të marrëveshjes kuadër. Certifikimi PMP/PRINCE2 është garanci për planifikim, organizim, monitorim dhe realizim efektiv të kontratës, duke siguruar menaxhim të standardizuar dhe profesional të projektit.

b) të paktën 4 (katër) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të kamerave (ose ekuivalent)

Kjo kërkesë vendoset pasi këta punonjës janë të angazhuar drejtpërdrejt në instalimin e sistemeve të kamerave. Certifikimi nga prodhuesi garanton që ata kanë njohuri të plota mbi produktin specifik që do të instalohet, duke siguruar instalim korrekt, konfigurim të saktë dhe shmangie të problematikave teknike gjatë implementimit dhe funksionimit të sistemit.

c) të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të alarmeve (ose ekuivalent)

Kjo kërkesë synon të sigurojë që instalimi i sistemeve të alarmeve të kryhet nga personel i trajnuar nga prodhuesi përkatës. Kjo garanton njohje të plotë të pajisjeve, instalim të saktë teknik dhe minimizim të problemeve gjatë funksionimit të sistemit të alarmit.

d) të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të akses kontrollit (ose ekuivalent)

Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar që sistemet e akses kontrollit të instalohen dhe konfigurohen nga personel i trajnuar nga prodhuesi. Kjo siguron implementim të saktë, integrim korrekt me sistemet ekzistuese dhe funksionim të qëndrueshëm të sistemit pa probleme teknike.

e) të paktën 2 (dy) punonjës me certifikatë për sigurinë teknike në punime elektrike (ose ekuivalent)

Kjo kërkesë është e domosdoshme pasi objekti i kontratës përfshin instalim, konfigurim dhe ndërhyrje në pajisje dhe sisteme që funksionojnë me energji elektrike. Certifikimi në sigurinë teknike garanton zbatimin e standardeve të sigurisë në punë, minimizimin e riskut të incidenteve elektrike dhe sigurimin që personeli ka njohuritë bazë për punë të sigurta në impiante elektrike. Kjo kërkesë është në përpjesëtim me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës.

Kërkesat për certifikim nga prodhuesit e sistemeve të kamerave, alarmeve dhe akses kontrollit janë të domosdoshme pasi kemi të bëjmë me sisteme sigurie të teknologjisë së lartë që funksionojnë 24/7 dhe përdoren në institucione shtetërore me rëndësi të veçantë. Certifikimi garanton që instalimi dhe konfigurimi kryhet nga persona të trajnuar, me njohje të plotë të produkteve dhe aftësi për zgjidhjen e problematikave gjatë instalimit, integritetit dhe periudhës së garancisë.

Ky kriter është në përputhje me parashikimet e nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe me nenin 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të cilat lejojnë përcaktimin e kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional në përpjesëtim me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, me qëllim garantimin e realizimit me sukses të saj.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë te pakten **4 (kater) automjete** për realizimin e instalimeve, për të cilët duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- a) Lejen e qarkullimit
- b) Policen e sigurimit
- c) Çertifikaten e kontrollit teknik
- d) Taksat vjetore

Ne rast se mjetet e lartpërmendura janë marre me qera ofertuesi duhet të paraqesë **Kontratën e marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 9, të DST-se dhe në zbatim të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mësipërme i shërben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve.

Duke marrë në konsideratë se për realizimin me sukses të kësaj procedure do të kryhen instalime në të gjithë vendin 4 automjete janë numri minimal i nevojshëm që dëshmojnë aftësinë e operatorit ekonomik për të bërë transportin e materialeve në pikat e montimit për të

paktën 4 grupe pune çdo ditë, për shkak të mbi 300 objekteve të cilat janë në ruajtje nga ana e shoqërisë.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se mallrat objekt prokurimi që do të ofertojë janë të reja.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbushë kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizimin me mallra të reja, sepse sigurojnë performancë optimale dhe përputhen me specifikimet teknike, garantojnë jetëgjatësi të gjatë dhe mirëmbajtje më të lehtë, janë të certifikuara sipas standardeve më të fundit të cilësisë dhe sigurisë, ofrojnë mbështetje teknike dhe akses në pjesë këmbimi. Kjo kërkesë nuk është vetëm formale, por thelbësore për cilësinë dhe besueshmërinë e furnizimit.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se mallrat objekt prokurimi që do të ofrojë kanë periudhën e garancisë të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike.

Argumentim:

Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e kërkesave teknike të Autoritetit Kontraktor. Ai siguron cilësinë dhe besueshmërinë e mallrave, redukton rrezikun e defekteve gjatë përdorimit, ul kostot e mirëmbajtjes për Autoritetin Kontraktor dhe garanton që çdo defekt gjatë periudhës së garancisë të mbulohet nga operatori ekonomik pa kosto shtesë.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se instalimi i sistemit të kamerave dhe alarmit në një objekt të caktuar, do të kryhet sipas tabelës më poshtë, duke filluar nga marrja e kërkesës zyrtare të dërguar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Nr.	Aktiviteti që do të kryhet	Nr. i ditëve të punës për objekt në Tiranë	Nr. i ditëve të punës për objekt jashtë Tiranës
1	FV Sistem vëzhgimi dhe alarmi 4 kanale	1	2
2	FV Sistem vëzhgimi dhe alarmi 8 kanale	1	2
3	FV Sistem vëzhgimi dhe alarmi 16 kanale	2	4
4	FV Sinjalizim dhe kamera teke	1	2

Nr.	Aktiviteti që do të kryhet	Nr. i ditëve të punës për objekt në Tiranë	Nr. i ditëve të punës për objekt jashtë Tiranës
5	FV Akses kontroll	1	2
6	FV Akses kontroll me njohje fytyre	1	2
7	FV Tra Parkimi	1	2
8	FV Tripodë	1	2
9	Dedektor metalik dore	1	1
10	Metal Dedektor tipi “Urë”	1	1

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se koha e reagimit dhe riparimit të defekteve, do të jetë brenda 48 orëve shtatë ditë të javës, duke filluar nga marrja e kërkesës zyrtare (shkresore ose e-mail) të dërguar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor, sepse Reagimi i shpejtë dhe riparimi brenda 48 orëve siguron vazhdimësinë e punës së pajisjeve dhe shërbimeve, duke shmangur ndalesa të gjata që ndikojnë negativisht në funksionimin e autoritetit kontraktor. Koha e shkurtër e reagimit rrit besimin në furnizuesin dhe siguron zgjidhje të shpejta për problemet teknike. Ndërhyrjet e shpejta parandalojnë dëmtime të mëtejshme dhe reduktojnë nevojën për riparime më të shtrenjta. Disponueshmëria 7 ditë në javë garanton që çdo problem do të trajtohet pa vonesa, pa marrë parasysh ditën apo orën.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha Kërkesat Funktionale dhe Specifikimet Teknike të kërkuara nga AK.

Argumentim: Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, do t’i përgjigjet kërkesave të AK në rast instalimi dhe riparimi defektsh me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me Nenin 4, pika 38/b ku citohet:

“Në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë dhe Nenin 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar) ku citohet: 2. “Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për garantimin e funksionimit të pandërprerë, modernizimit dhe zgjerimit të infrastrukturës së sigurisë elektronike të administruar nga “Illyrian Guard” Sh.A., e cila operon në nivel kombëtar dhe funksionon në regjim 24/7. Nevoja për këtë procedurë lidhet me rritjen e objekteve nën administrim, zëvendësimin e pajisjeve të amortizuara dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit.

NJËSIA E PROKURIMIT